

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

**Auditimi i avancuar dhe
siguria
(me zgjidhje)**

P10

Data 03/10/2020

Detyra 1

Hija Tours shet pako turistike gjithëpërfshirëse (inkluzive) (psh fluturimin ndërkombëtar, akomodimin në hotel dhe ushqimin) për 2 milion konsumatorë. Të gjitha hotelet zotërohen dhe menaxhohen të pavarur nga njëri tjetri. Kompania punëson 5,000 persona dhe shfrytëzon 11 aeroplan të marrë me qira. Hija Tours ka përfaqësi në 13 lokacione për pushime. Firma juaj është ftuar të ofertojë për auditimin e Hija për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020. Si menaxher i ardhshëm i auditimit, nga ju është kërkuar të identifikoni rreziqet kryesore të auditimit dhe çështjet tjera të planifikimit të auditimit, përfshirë strategjinë e auditimit, që duhet të paraqiten si pjesë e ofertës tuaj për auditim.

Ju keni marr informatat në vijim nga raporti vjetor i kompanisë të vitit 2019.

(i) Pushimet shiten përmes agjencionit Isa Tours, e cila agjenci ka 29 përfaqësi (në vitin 2018: 31 përfaqësi). Metoda e shitjes përmes qendrave të thirrjeve me telefon është mënyra që po rritet më së shpejti dhe gjithashtu tani po ofrohen edhe rezervime përmes internetit.

(ii) Sistemi i kontrollit të brendshëm financiar përfshinë:

- Sistemet e planifikimit dhe buxhetimit janë të ndara në divizione dhe bëhen rishikime të rregullta nga Bordi i rezultateve aktuale me ato të buxhetuarat dhe krahasimet me vitet e mëparshme;
- Kompania ka funksionin e auditimit të brendshëm dhe raportet e auditimit të brendshëm rishikohen nga Komiteti i Auditimit.

(iii) Ekstraktet financiare (€m):

	2019	2018
Të hyrat (Shënimi 1)	942.8	763.7
Fitimi operativ para tatimit	27.3	25.7
Pasuri jo qarkulluese të trupëzuara	109.1	80.3
Të arkëtueshme tregtare	29.7	18.2
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	138.6	91.0
Detyrimet afatshkurta (Shënimi 2)	(237.2)	(200.5)
5% Bono e konvertueshme e pagueshme në vitin 2015 (Shënimi 3)	(73.0)	-

Shënimet

(1) Të hyrat përfaqësojnë të hyrat bruto të arkëtueshme nga paketot turistike inkluzive dhe komisionet nga agjencionet turistike. Të hyrat dhe shpenzimet që lidhen me paketot inkluzive paraqiten në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në momentin e nisjes së pushimit.

(2) Të hyrat e pranuar në avans të përshira në detyrimet afatshkurta janë gjithsej €69.9 milion (2018: €61.4 milion)

(3) Bonot do të ripaguhën me shumën e principalit me 7 janar 2023 përveç nëse konvertohen sipas opsionit të mbajtësit të borxhit në çfardo kohe para 31 dhjetorit 2022.

(4) Detyrimet vjetore të lizingut të pa anulueshëm janë siç vijon (€m):

	2019	2018
Më pak se një vit	4.3	2.5
Në mes një dhe pesë vite	16.7	17.9
Pesë ose më shumë vite	17.4	12.7
Gjithsej	38.4	33.1

Kërkohet

(a) Shpjegoni çështjet e planifikimit të auditimit të cilat duhet të përfshihen në ofertën e shkruar siç ka kërkuar Hija Tours. **(20 pikë)**

Zgjidhja

(a) Çështjet e planifikimit

Rreziku

Rreziku rritet nga faktorët në vijim:

(i) Natyra e biznesit

- Biznesi i 'pushimeve' është shumë konkurrues dhe sidomos me çmimet e ulëta që ofrohen nga konkurrenca për të fituar pjesë ta tregut. Kjo ka rezultuar me kolaps të operatorëve turistik në të kaluarën.
- Kompania operon nga 13 lokacione të pushimeve.
- Shpërndarja gjeografike e biznesit është faktorë që rritë rrezikun e kontrollit. Biznesi po ashtu do të nënshtrohet ligjeve kombëtare dhe ata duhet të jetë në dijen për këtë.
- (ii) *Çështjet financiare*
- Njëra nga kostot më domethënëse me të cilat kompania ballafaqohet është karburanti i aeroplanëve. Ky çmim përcaktohet nga tregjet dhe është faktorë mbi të cilin kompania mund të ketë shumë pak kontrollë.
- Kompania ekspozohet rrezikut të këmbimit valuator për shkak të natyrës së biznesit dhe për shkak të shpërndarjes gjeografike të lokacioneve.
- (iii) *Struktura e biznesit*
- Ky është biznes i bazuar në para të gatshme se sa në kapital. (Për shembull aeroplanët merren me qira dhe nuk janë në pronësi të kompanisë). Kjo rritë rrezikun e likuiditetit. Kompania duhet të ruakë nivele të larta të parasë për të bërë pagese të qirasë dhe për të përmbushur detyrime tjera.
- Rreziku i kontrollit ka mundësi të jetë i ulët. Mjedisi i kontrollit duket se është i fortë me procedura të vendosura. Kompania ka planifikim nëpër divizione dhe sistem të buxhetimit dhe Bordi duket se i rishikon me seriozitet rezultatet.

(iv) Metodatat e shitjes

- Një numër në rritje i shitjeve është duke u gjeneruar si rezultat i qendrave të thirrjeve. Kjo ka avantazhë në zvogëlimin e kostos së biznesit dhe lehtësi për konsumatorët. Qendrat e thirrjeve shpesh janë mjedise me presion të lartë në të cilin puna mund t'i nënshtrohet ankesave lidhur me problem shëndetësorë.
- Kompania është duke u zgjeruar në e-commerce. Kjo rritë rrezikun e sigurisë së të dhënave. Shitjet përmes internetit duhet të bëhen përmes faqeve të sigurta të internetit.
- Përdorimi në rritje i shitjeve përmes qendrave të thirrjeve dhe internetit mund të çojë në humbjen e shitjeve përmes agjencive.
- Përderisa në afat të gjatë kohor zhvillimi i qendrave të thirrjeve dhe internet do të zvogëlojë koston e biznesit, në afat të shkurtër kohor, kostot mund të rriten për shkak të dyfishimit të këtyre kostove.

Strategjia

Mund të ndërmerret strategjia në vijim:

- Qasja e bazuar në rrezik. Kjo bazuar në faktin se:
 - Identifikimi i rreziqeve është bërë
 - Ekzistencës së rreziqeve
 - Vështëresive praktike në përdorimin e qasjes alternative psh qasja thelbësore për shkak të numrit të madh të lokacioneve, etj

Mbështetja në kontrollin e brendshëm

Për shkak të çështjes praktike, mbështetja në kontrollin e brendshëm do të rezultonte me auditim më efikas. Kjo veçanarisht është e rëndësishme pasi që biznesi ka vëllim të lartë të transaksioneve dhe lokacione të shumëfishta. Në mënyrë që të mbështetemi në kontrollin e brendshëm, mjedisi i kontrollit duhet të jetë i fortë dhe procedurat e kontrollit të funksionojnë me efektivitet. Indikacionet fillestare janë të mira pasi që ekziston kontrolli buxhetor dhe rishikohet me rregull. Megjithatë duhet të bëhen vlerësime në vijim:

- Rregullsia e rishikimeve buxhetore

- Veprimet që merren si rezultat i këtyre rishikimeve. Kjo veçanërisht është e rëndësishme ku ka shmangie të mëdha

Mund të mbështetemi edhe në auditimin e brendshëm. Vlerësimi në këtë rast do të përfshinte:

- Statusin organizativ të AB (kjo duket e mirë pasi që komiteti i auditimit rishikon raportet e AB)
- Objekti i funksioneve dhe veprimeve që ndërmerr komiteti i auditimit si rezultat i rishikimeve
- Kompetenca teknike
- Kujdesi i duhur profesional, psh, cilësia e raporteve të prodhuara

Përdorimi i procedurave analitike

Ka mundësi të përdoren për shkak të disponueshmërisë së të dhënave. Planifikimi divisional dhe dokumentet buxhetore mund të përdoren për të bërë krahasime me rezultatet aktuale.

Natyra e disa llojeve të të hyrave dhe shpenzimeve po ashtu hapin rrugën për procedura analitike.

Materialiteti

Materialiteti paraparak mund të jetë në shifrën e €4.4 milion. Kjo është një mesatare e nxjerrë nga llogaritjet dhe vlerësimin e përgjithshëm të rrezikut:

½-1% e qarkullimit = €4.7m – €9.4m

1%-2% e pasurive totale = €2.8m – €5.5m

5%-10% e fitimit para tatimit = €1.4m – €2.7m

(nëse konsiderohet se ka rrezik të lartë, materialiteti mund të vlerësohet në €2.9m.)

Trajtimet në kontabilitet

Duhet të vlerësohet trajtimi i përshtatshëm në kontabilitet sidomos në fushat në vijim:

(i) Lizingu operativ

(ii) Njohja e të hyrave

Të hyrat dhe kostot aktualisht njihen në momentin kur fillon pushimi. Kur ka numër domethënës të pushimeve afatgjata kjo mund të jetë politike e pamatur që mund të rezultojë me mbivlerësim të të hyrave dhe fitimeve. Prerja në fund të vitit mund të jetë e ndjeshme.

Evidencat

Siç është përmendur më sipër, procedurat analitike do të përdoren më shumë pasi që ofron auditim më efikas dhe efektiv. Krahasimet në mes viteve shpalosin të dhënat në vijim:

Të hyrat janë rritur me 23.5%. Kjo ka mundësi të jetë për shkak të zgjerimit të biznesit dhe shitjet direkte. Një ndarje e detajuar e të hyrave mund të qartësojë arsyen e saktë.

Fitimi operativ është rritur me 6.2% që përfaqëson vetëm 2.9% të qarkullimit. Kjo mund të jetë për shkak të:

- Rritjes së kostove operative. Nëse kjo ka të bëjë me zhvillimin e shitjeve direkte, përfitimet nga këto kosto do të duken në të ardhmen. Në të kundërtën mund të jetë tregues i kontrollit të dobët të kostove.
- Marzhat e zvogëluara. Për shkak të rritjes së konkurrencës, mund të jenë zvogëluar çmimet. Mund të jenë ofruar oferta special për të inkurajuar konsumatorët për të përdorur shërbime të reja.

Pasuritë joqarkulluese të prekshme janë rritur me 35.9%. Përbërja e këtyre shtesave mund të qartësohet edhe pse duket se kjo është për shkak të qendrave të thirrjeve. Duket se këto qendra janë financuar duke lëshuar bono të konvertueshme.

Të arkëtueshmet janë rritur me 63%

Ditët e LLA janë rritur nga 8.7 në 11.5 ditë që është shqetësuese sidomos për shkak të natyrës së biznesit sepse është më vështirë të mbledhen borxhet nga konsumatorët individual.

Paraja është rritur me 52%. Kjo është për shkak të lëshimit të bonove të konvertueshme. Rrjedha e parasë për këtë biznes është kritike.

Në terma absolute të hyrat e pranuar në avans janë rritur me 13.8%. Si proporcion i qarkullimit, megjithatë ka rënë nga 8.0% në 7.4%.

Kjo mund të jetë rezultat i zvogëlimit të rezervimeve në avans. Psh konsumatorët përmes internetit mund të rezervojnë në minutën e fundit.

Çështjet praktike

Biznesi përbëhet nga 13 lokacione të biznesit dhe 29 agjencie. Për shkak të numrit të lokacioneve mund të ndërmerret qasja në vijim:

- Vetëm lokacionet më të mëdha mund të vizitohen.

Për ato lokacione që nuk vizitohen, mund të rishikohen raportet e degëve.

Detyra 2

Ju jeni menaxheri përgjegjës për auditimin e Grama, një kompani me përgjegjësi të kufizuar që operon tashmë disa vite. Grama operon me një zingjir të supermarketeve prej 23 shitoreve, pesë nga të cilat janë në kryeqytetin Prishtinë. Të gjitha shitoret menaxhohen në të njëjtën mënyrë duke i realizuar blerjet nga departamenti i centralizuar i blerjeve, vendosjes së çmimeve, marketingut, politikave të burimeve njerëzore, të gjitha të centralizuara. Pasqyrat financiare draft për vitin që përfundon me 30 shtator 2020 paraqesin të hyra prej €303 milion (2019 – €282 milion), fitim para tatimit prej €9.5 milion (2019 – €7.3 milion) dhe pasuri totale prej €178 milion (2018 – €173 milion).

Çështjet në vijim janë paraqitur gjatë auditimit përfundimtar dhe janë shënuar në dosje për tu rishikuar nga ju:

(a) Me 1 nëntor 2020, Grama shpalli synimin e saj të zvogëlojë aktivitetin për një supermarket në kryeqytet dhe ta shndërronte atë në një minimarket si përgjigje ndaj zvogëlimit në kërkesën për stilin e supermarketeve në kryeqytet. Supermarketi do të jetë i mbyllur gjatë tërë dhjetorit dhe do të rihapet me 1 janar 2021. Zëri i mirë prej €5.5 milion ishte njohur tre vite më parë kur ky supermarket, së bashku me dy të tjerë ishte blerë nga një konkurrent kombëtar. Kompania nuk ka bërë rishikime për dëmtim të zërit të mirë. **(7 pikë)**

(b) Me 1 tetor 2019 Grama kishte paraqitur një 'skemë të shpërblimeve' për konsumatorët e saj. Elementët kryesore të skemës përfshijnë dhurimin e 'pikëve' për konsumatorët në kartelat e tyre të lojalitetit për çdo €1 të shpenzuar, me pikë shtesë për blerje gjatë ofertave javore. Konsumatorët të cilët mbajnë këto kartela të lojalitetit mund t'i shndërrojnë pikët në zbritje me para për blerjet në të ardhmen bazuar në €1 për 100 pikë. **(6 pikë)**

(c) Në prill 2020, Grama fillojë zhvillimin e një kompleksi në një luginë 'me bukuri natyrore të përkryer' në të cilën vend do të ndërtojë një 'megamarket' dhe një depo deri kah fundi i vitit 2021. Leja e ndërtimit nga komuna që është pranuar në tetor 2020, kërkon që 3 nga drunjët 100 vjeçar që gjenden në atë luginë të ruhen dhe rrethina të restaurohet po ashtu në vitin 2021. Blerjet/shtesat në llogarinë e ndërtesave dhe pajisjeve gjatë vitit përfshijnë €4.4 milion kosto për restaurimin e luginës. Ky vlerësim përfshinë provizionin prej €0.4 milion për rilokimin e drunjëve 100 vjeçar.

Në shtator 2020 drunjët ishin copëtuar për të bërë vend për parkim. Një gjobë prej €20,000 për dru ishte paguar në komunë në nëntor 2020. **(7 pikë)**

Kërkohet

Për secilën nga çështjet e mësipërme:

- (i) Komentoni mbi çështjet që duhet të konsideroni
- (ii) Tregoni evidencat e auditimit që ju prisni t'i gjeni gjatë rishikimit të letrave të punës së auditimit dhe rishikimit të pasqyrave financiare të Grama për vitin që përfundon me 30 shtator 2020.

Supozoni se është 11 dhjetor 2020.

(Total = 20 pikë)

Zgjidhja

(a) Zvogëlimi i shitores

(i) Çështjet që duhet të konsiderohen

- Vendimi për të zvogëluar është një ngjarje që nuk kërkon korrigjim pas datës së raportit e cila duhet të shpaloset në pasqyrat financiare.
- Vendimi mund të jetë tregues i dëmtimit të aseteve të shitores dhe po ashtu që lidhet me emrin e mirë.
- Vlëra bartëse e emrit të mirë (€2.2 milion) nuk është material për pasqyrën e pozicionit financiar, por me 23% të fitimit para tatimit është material për pasqyrën e të ardhurave.
- Mirëpo, emri i mirë ka të bëjë me tre shitore. Mund të mos jetë e mundur ti atribuohet ndonjë pjesë e emrit të mirë ndonjëres prej shitoreve dhe pjesa që i takon kësaj shitore mund të mos dëmtohet fare.

- Nuk është e qartë nëse aset i shitores është materiale, por pasi që emri i mirë i shoqëruar me shitoren është materiale për pasqyrën e të ardhurave, ka mundësi që të bëhet dëmtimi i këtij emri të mirë.
- Menaxhmenti duhet të kishte bërë testin e dëmtimit për tu siguruar nëse ky asset duhet të dëmtohet.
- Menaxhmenti po ashtu duhet të konsiderojë nëse ndonjëra nga shitoret tjera të kryeqytetit mund të ndikohet nga probleme të ngjashme prandaj edhe të bëhet dëmtimi.
- Në fund, nëse zbulohet problem i njëjtë në kryeqytet, atëherë kjo mund të jetë indikacion për probleme me supozimin e vijimësisë. Menaxhmenti do të duhej të konsideronte se ky është problem vetëm me këtë shitore.

(ii) *Evidenca e auditimit*

- Regjistrat për vendimin e zvogëlimit të shitores
- Rishikimi i dëmtimit nga menaxhmenti
- Rillogaritja e vlerës bartëse të asetit
- Inspektimi fizik i shitores së mbyllur
- Informatat e rishikimit të vijimësisë nga menaxhmenti

(b) **Skema e shpërblimit**

(i) *Çështjet që duhet të konsiderohen*

- Nëse tërë të hyrat për vitin tërheqin pikë të shpërblimit, kosto minimale e pikëve të shpërblimit do të ishte €3.03 milion (pasi që pikë shtesë mund të fitohen nga ofertat special) e cila është 1% e qarkullimit dhe 32% e fitimit para tatimit, prandaj është materiale.
- Për shkak të ndikimit të madh në fitim, edhe nëse kartelat e shpërblimeve nuk janë marrë nga të gjithë konsumatorët, kjo çështje ende mund të jetë materiale.
- Kompania shkakton detyrime të paguajë zbritje në të ardhmen në momentin e shitjes së parë, dhe shpenzimi dhe detyrimi duhet të njihen në kohën e shitjes.
- Pasi që kjo skemë e zbritjeve është e ngjashme me zbritjet me para, shitjet duhet të regjistrohen me çmim të plotë, ndërsa zbritjet të përfshihen në shpenzime në pasqyrën e të ardhurave.
- Në fund të vitit, kompania do të ketë detyrim të paguajë këto zbritje për pikët e pa shfrytëzuara lidhur me shitjet e vitit. Kjo nuk do të jetë materiale për pasqyrën e pozicionit financiar pasi që shpenzimi i tërësishëm i vitit të parë nuk është material për pasqyrën e pozicionit financiar
- A mund të përdoren pikët nga shitoret për çfardo qëllimi tjetër përveç përfitimit të zbritjeve në të ardhmen
- Nëse ka ndonjë kufizim kohor për të kërkuar zbritjet
- Shkalla deri në çmasë pikët e fituara pritet të kërkojnë si zbritje

(ii) *Evidenca e auditimit*

- Dokumentimi i sistemit që ofron informata për skemën e shpërblimeve (si përdoren kartelat, si regjistrohen pikët në momentin e shitjes, dhe si kërkojnë zbritjet)
- Testet hap-pas-hapi për të konfirmuar se sistemi operon ashtu siç është përshkruar
- Testet e kontrollit se si transformohet informata nga pika e shitjes në informatë kontabël
- Rishikimi analitik mbi numrin e pikëve të lëshuara nga secila shitore çdo muaj (kjo pritet të jetë përafërsisht është 1% e qarkullimit) me shpjegime për ndryshime
- Testet e detajeve në një mostër të transaksioneve përfshirë lëshimin e pikëve

(c) **Ristaurimi i tokës**

(i) *Çështjet që duhet të konsiderohen*

- Totali i provizionit prej €4.4 milion është materiale për pozicionin financiar sepse është 2.5% e pasurive totale.
- Ka një mbi-provizionim prej €0.34 milion e cila është jomateriale për pasqyrën e pozicionit financiar individualisht.

- Nëse do të ndërmerr komuna veprim serioz kundër kompanisë nëse ajo nuk rristuron tokën
- SNK 37 lejon një provision nëse:
 - Ekziston një obligim të tanishëm si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën
 - Ka mundësi të transferohet përfitimi ekonomik
 - Mund të vlerësohet me besueshmëri
- Nëse komuna nuk do të ndërmarr veprim serioz, atëherë deri sa kompania ka obligim ligjor si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, kërkesa e dytë e SNK 37 nuk është përmbushur, pasi që nuk ka probabilitet të transferohet një përfitim ekonomik për të përmbushur këtë obligim

(ii) *Evidenca e auditimit*

- Një kopje e aplikacionit për leje të ndërtimit dhe leja e ndërtimit
- Një kopje e korrespondencave në të cilat caktohet gjoba për drunjët
- Rillogaritja e provizionit prej €4.4 milion
- Inspektimi i pasurisë (tokës) në fund të vitit
- Çfardo kontrate ose dokumenti i cili mund të ofrojë evidencë të qëllimit të menaxhmentit sa i përket restaurimit të tokës (kontratat ndërtimore me kontraktorët)

Detyra 3

(a) Qëllimi i SNA 510 *Auditimet fillestare – gjendjet (saldot) fillestare* është të themelojë një standard dhe ofroj udhëzime sa i përket gjendjeve fillestare kur pasqyrat financiare auditohen për herë të parë ose kur pasqyrat financiare për periudhën e mëparshme janë audituar nga një auditor tjetër.

Kërkohet

Shpjegoni përgjegjësinë e auditorit për angazhimet fillestare. **(7 pikë)**

(b) Ju jeni menaxheri i auditimit të Loni Shpk. Pasqyrat financiare draft të konsoliduara për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2019 paraqesin fitim para tatimit prej €10.5 milion (2018 – €9.4 milion) dhe pasuri totale prej €55.2 milion (2018 – €50.7 milion).

Firma juaj është caktuar si auditor i Yllka Shpk në kohën kur Loni Shpk kishte blerë të gjitha aksionet e Yllka Shpk në dhjetor 2019. Pasqyrat draft të Yllka për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2019 paraqesin fitim para tatimit prej €0.7 milion (2018 – €1.7 milion) dhe pasuri totale prej €16.1 milion (2018 – €16.6 milion). Raporti i auditorit mbi pasqyrat financiare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018 ishte i pamodifikuar.

Aktualisht jeni duke rishikuar dy çështje që janë paraqitur për ju në dosjen e letrave të punës për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2019:

- (i) Në shtator 2018 Yllka kishte instaluar një sistem të ri të kompjuterizuar që kishte zbuluar mbivlerësimin e stokeve në vlerë prej €2.7 milion. Kjo shumë e stokeve është duke u shlyer për periudhë 3 vjeçare.
- (ii) Në korrik 2019, zyra qendrore e Yllka Shpk ishte rilokuar në ndërtesat e Loni Shpk si pjesë e ristrukturimit. Provizionet për tepricat e punëtorëve nga kjo lëvizje dhe nga pagesat e paanulueshme të lizingut kanë vlerën prej €2.3 milion dhe janë regjistruar në pasqyrat financiare të Yllka Shpk për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2019.

Kërkohet

Identifikoni dhe komentoni mbi implikimet e këtyre dy çështjeve në raportin e auditorit të pasqyrave financiare të Loni Shpk dhe Yllka Shpk për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2019.

(13 pikë)

Supozoni se është 11 mars 2020. **(Total = 20 pikë)**

Zgjidhja

(a) Përgjegjësia e auditorit për angazhimet fillestare

Auditori duhet të përftojë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit që saldot fillestare nuk përmbajnë anomali të cilat mund të ndikojnë në mënyrë materiale pasqyrat financiare të këtij viti. Auditori duhet po ashtu të përftojë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit që politikat e kontabilitetit janë zbatuar me konsistencë. Nëse nuk mund të përftohet evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme, raporti i auditorit duhet të rezervohet ose të refuzohet.

Nëse saldot fillestare përbajnë anomali që mund të ndikojnë materialisht në pasqyrat financiare, auditori duhet të informojë menaxhmentin e klientit dhe auditorin e mëparshëm. Nëse efekti i anomalive nuk trajtohet si duhet dhe nuk shpaloset, auditori duhet të jep një opinion me rezervë ose të refuzojë opinionin.

Nëse politikat e perudhës aktuale nuk janë zbatuar me konsistencë në saldot fillestare auditori duhet të jep një opinion me rezervë ose të refuzojë opinionin.

Nëse raporti i auditorit të vitit të kaluar ishte i modifikuar, auditori duhet të konsiderojë efektin në pasqyrat e këtij viti. Nëse modifikimi mbetet relevant dhe material për pasqyrat e këtij viti, raporti i auditorit për këtë vit duhet të modifikohet gjithashtu.

Duhet të përfshihet një paragraf i çështjeve tjera në raportin e auditorit nëse pasqyrat e vitit të kaluar nuk ishin audituar ose janë audituar nga një auditor tjetër. Kjo duhet të ndodhë pa marrë parasysh nëse janë ose jo me anomali materiale dhe po ashtu ky fakt nuk e liron auditorin të përftojë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit për saldot fillestare.

(b) (i) Stoqet duhet të vlerësohen me kosto ose me vlerën neto të realizueshme cilado që është më e ultë sipas SNK 2. Mbivlerësimi prej of €2.7 milion është identifikuar në vitin 2011 dhe duhet të shlyhen gjatë atij viti. Nuk duhet të shlyhen për periudhën 3 vjeçare.

Stoqet prandaj janë të mbivlerësuara për €0.9 milion në vitin që përfundon me 31 dhjetor 2012. Kjo përfaqëson 5.6% të pasurive totale dhe 129% të fitimit para tatimit prandaj është materiale. Në vitin e kaluar, stoqet do të ishin mbivlerësuar për €1.8 milion, kështu që fitimi i raportuar do të ishte në fakt humbje.

Raporti i auditimit të vitit të kaluar ishte i pamodifikuar, që nënkupton se auditori i mëparshëm ose është pajtuar me trajtimin kontabël ose përndryshe ka dhënë një opinion të papërshtatshëm për pasqyrat financiare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2011. Kërket një korrigjim i periudhës së mëparshme në pajtueshmëri me SNK 8 Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet, prandaj shifrat krahasuese për periudhën paraardhëse të rezervave për efektin kumulativ.

(ii) Një provision prej €2.3 milion është bërë nga kompania për tepricën e punëtorëve dhe për pagesat e qirasë së paanulueshme që do të rezultojnë nga ristrukturimi. Kjo paraqet 14% të pasurive totale për vitin dhe prandaj është shumë materiale.

Sipas SNK 37 Provizionet, detyrimet kontingjente dhe pasuritë kontingjente, duhet të bëhet një provision nëse entiteti ka një obligim të tanishëm si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, është i mundshëm transferi i përfitimit ekonomik për ta paguar obligimin dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet për shumën e obligimit.

Në këtë rast, nuk ka mundësi të madhe të ketë një obligim të tanishëm në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, pasi që kompania është blerë diku në dhjetor prandaj është shumë afër fundit të. Përveç kësaj provizioni për kostot e ristrukturimit duhet të njohet nëse është pëgatitur një plan formal dhe është bërë shpallje publike për planin. Nëse nuk ka ndodhur kjo, provizioni nuk do të duhej të njihet në pasqyrat e vitit që përfundon me 31 dhjetor 2012. Ristrukturimi duhet të shpaloset në pasqyra për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2012 si një ngjarje që nuk kërkon korrigjim sipas SNK 10 Ngjarjet pas periudhës raportuese.

Efekti në raportin e auditorit të Loni

Nëse kërket korrigjim sa i përket dy çështjeve të mësipërme, opinion i auditorit për Loni Shpk duhet të jetë parezervë. Mirëpo nëse nuk bëhen korrigjimet, opinion duhet të jetë me rezervë bazuar në anomalitë materiale. Ky do të ishte një rezervim me 'përveç për' pasi që çështjet nuk janë përhapëse për pasqyrat financiare.

Efekti në raportin e auditorit të Yllka

Nëse janë bërë korrigjimet e kërkuara në pasqyrat financiare të Loni, atëherë edhe opinion i auditorit të Yllka do të jetë parezervë. Nëse nuk bëhen korrigjimet, mund të jenë bërë në konsolidimin e Loni për të shmangur rezervimin e opinionit të Yllka. Mirëpo një rezervim me 'përveç për' do të rezultonte në pozicionin financiar nëse këto korrigjime nuk do të ishin bërë gjatë konsolidimit, por rezultatet e operacioneve do të ishin parezervë.

Detyra 4

(a) Ju jeni menagjeri përgjegjës për auditimin e Xixa ShA, një kompani që dizajnon dhe zhvillon motorë për aeroplan.

Auditimi për vitin që përfundoi me 31 korrik 2019 është duke përfunduar dhe seniori i auditimit e ka lënë një shënim në dosje për tu rishikuar nga ju:

‘Sapo jam kthyer nga një takim me menaxhmentin e Xixa ShA, dhe është një çështje që dua të diskutohet. Në pasqyrën e pozitës financiare ka pasuri të patrupëzuara në vlerë prej €12.5 milion që kanë të bëjë me kosto të kapitalizuara të hulumtimit dhe zhvillimit lidhur me dizajnin e një motori të aeroplanit. Mirëpo, hulumtimi i tregut i kryer nga Xixa lidhur me këto dizajne të reja ka treguar se do të ketë kërkesë të pakët në të ardhmen e afërt për një dizajn të tillë.

Menaxhmenti ka ofruar përfaqësim të shkruar se ata pajtohen me rezultatet e këtij hulumtimi të tregut.

Momentalisht, Xixa ka një saldo të parasë prej vetëm 125,000 Euro dhe menaxhmenti kanë shprehur shqetësime se kompania e ka të vështirë të gjejë financim shtesë. Dizajnet e reja të motorëve janë diskutuar edhe në deklaratën e kryesuesit të bordit të kompanisë, deklaratë e cila do të publikohet me pasqyrat financiare. Kjo deklaratë thekson se ‘zhvillimet e motorëve të rinj janë në vijim dhe besojmë se këto do të jenë burime domethënëse të të hyrave për Xixa në 12 muajt në vijim’.

Pasqyrat financiare draft të Xixa përfshijnë fitim para tatimit prej 23 milion dhe pasuri gjithsej prej 210 milion.

Xixa do të publikojë raportin vjetor javën që vjen, prandaj na duhet të konsiderojmë ndikimin e kësaj çështjeje urgjentisht.’

Kërkohet:

Diskutoni implikimet e shënimit të lënë nga seniori i auditimit që ka në përfundimin e auditimit dhe në raportin e auditimit, duke rekomanduar çfardo veprimi në të ardhmen që duhet të ndërmerret nga auditorët. (12 pikë)

(b) Ju jeni përgjegjës për ofrimin e shpjegimeve teknike në pyetjet nga menaxherët dhe partnerët tjerë të firmës. Njëri nga partnerët e auditimit i bëri disa pyetje këtë mëngjes:

(iii) ‘Jam në proces të përpilimit të raportit të auditimit draft për klientin tim, Sara. Do të shkoj në pushime nesër dhe dua ta nënshkruaj dhe datoj raportin e auditimit para së të largohem. E vetmja gjë e mbetur është letra e përfaqësimit nga menaxhmenti – e kam konfirmuar në mënyrë verbale përmbajtjen e kësaj letrë me drejtorin financiar të kompanisë i cili u pajtua të dërgojë letrën e përfaqësimit tek menaxheri i auditimit brenda disa ditëve në vijim. Besoj se kjo është e pranueshme?’ (4 pikë)

(iv) ‘Jemi duke e audituar Sara për herë të parë. Pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme ishin audituar nga një firmë tjetër. Jemi në dijeni se raporti i auditorit për periudhën e mëparshme ishte me rezervë për shkak të anomalive materiale në llogaritë e arkëtueshme. Ne kemi përfutur dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme se çështja që kishte shkaktuar anomalinë ishte zgjidhur dhe jam i kënaqur të jap një opinion të pamodifikuar. Por a duhet t’i referohem modifikimit të vitit të mëparshëm në raportin e këtij viti?’ (4 pikë)

Kërkohet:

Përgjigjuni komenteve të partnerit të auditimit.

Shënim: shpërndarja e pikëve është paraqitur në secilën pyetje më sipër.

(20 pikë)

Zgjidhja

(a) Pasuria e patrupëzuar në vlerë prej €12.5 milion është materiale për pasqyrën e pozitës financiare, duke përfaqësuar 6% të pasurive totale. Shuma po ashtu është materiale për fitimin duke përfaqësuar 54% të fitimit para tatimit.

Duket se kriteri për kapitalizim të kostove të zhvillimit që adresohet në SNK 38 Pasuritë e patrupëzuara nuk është përmbushur, për dy arsye. Së pari SNK 38 kërkon që entiteti duhet të jetë në gjendje të demonstrojë se si pasuria e patrupëzuar do të gjenerojë përfitime të mundshme ekonomike në të ardhmen.

Në mes gjërave tjera, entiteti duhet të demonstrojë ekzistencën e tregut për produktin e pasurive të patrupëzuara, ose nëse do të përdoret së brendshmi, dobishmërinë e asaj pasurie të patrupëzuar.

Hulumtimi i tregut i kërkues nga kompania tregon se mund të mos ketë përfitime ekonomike në të ardhmen nga produkti që është zhvilluar, gjë që ishte konfirmuar edhe përmes përfaqësimit të shkruar. Kjo tregon se puna e auditimit duhet të vjen në përfundim se kriteri i njohjes nuk është përmbushur prandaj pasuria e patrupëzuar duhet të çregjistrohet.

Një kriter tjetër nga SNK 38 është entiteti duhet të jetë në gjendje të demonstrojë disponueshmëri të burimeve teknike, financiare dhe të tjera për të përfunduar zhvillimin dhe për ta shitur ose përdorur pasurinë e patrupëzuar. Pasi që kompania duket se nuk ka fonde të mjaftueshme, është çështje diskutabile nëse do të ketë fonde të mjaftueshme për të përfunduar zhvillimin dhe për ta lansuar në treg këtë produkt. Kjo më tutje tregon se pasuria duhet të çregjistrohet dhe të gjitha kostot e zhvillimit të njihen si shpenzime operative.

Bazuar nga çështjet më lart, pasqyrat financiare draft përmbajnë një anomali material, pasi që pasuritë joqarkulluese janë mbivlerësuar, fitimet janë mbivlerësuar për një shumë material.

Auditori duhet ta diskutojë këtë çështje me menaxhmentin duke ia shpjeguar problemin me trajtimin kontabël dhe të kërkojë që pasqyrat financiare të ndryshohen.

Nëse nuk bëhet asnjë ndryshim, auditori duhet të konsiderojë modifikimin e raportit, i cili mund të jetë me rezervë për shkak të materialitetit.

Firma duhet të konsiderojë zgjerimin e punës së auditimit lidhur me çështjen e vijimësisë së kompanisë, sidomos pas shqetësimeve të menaxhmentit se kompania ka vështirësi të gjejë financim. Letrat e punës së auditimit duhet qartë të dokumentojnë vlerësimin e statusit të vijimësisë së kompanisë dhe nëse ka ndonjë dyshim për këtë status.

Firma e auditimit po ashtu duhet të konsiderojë nëse trajtimi i kostove të zhvillimit si pasuri e patrupëzuar paraqet raportim financiar mashtroes. Nëse kompania ka vështirësi të gjejë financim, mund të ketë shtytje që kompania të paraqes poitë financiare të shëndoshë, e cila do të arrihej përmes përfshirjes së këtyre kostove në pasuri/asete.

Duke pasë parasysh madhësinë e pasurive të patrupëzuara në pasqyrat financiare, dhe rezervimin e mundshëm të opinionit nga auditori, është shumë e rëndësishme që puna e auditimit të rishikohet me kujdes, mundësisht nga një partner tjetër i cili nuk është involvuar në auditimin e kompanisë, për të siguruar se puna e auditimit është kryer me cilësi dhe i mbështet përfundimet e auditorit.

Raporti vjetor planifikohet të publikohet javën tjetër. Partneri i nagazhimit mund të diskutojë nëse ky publikim mund të shtyhet deri sa të merren dëshmi tjera lidhur me produktet e raja dhe parimin e vijimësisë, psh nëse ndonjë konsumator është gati të nënshkruaj një kontratë për produktin e ri që do të ofronte konfirmim për përfitimin ekonomik që del nga hulumtimi dhe zhvillimi.

Çështja tjetër që duhet të adresohet është jokonsistenca e deklaratës së kryesuesit të bordit në raportin vjetor dhe dëshmitë e auditorit që rezultojnë me ndryshimin e pasqyrave financiare. Deklarata e kryesuesit nënkupton se produktet do të jenë të suksesshme në afat të shkurt, ndërsa dëshmitë e auditimit e kundërshtojnë këtë thënie.

Kjo jokonsistencë duhet të diskutohet me menaxhmentin dhe partneri i angazhimit duhet të inkurajojë kryesuesin që të ndryshojë deklaratën. Sipas SNA 720 Përgjegjësia e auditori lidhur me informatat tjera në dokumentet që përmbajnë pasqyrat financiare, nëse menaxhmenti refuzon të bëjë

revidimin e nevojshëm të deklaratës së kryesuesit atëherë duhet të përfshihet paragrafi i Çështjeve tjetra në raport të auditorit për të përshkruar jokonsistencën. Opinioni i auditorit nuk do të modifikohet lidhur me këtë jokonsistencë.

Për të gjitha këto çështje duhet të informohet menaxhmenti ose ata që janë të ngarkuar me qeverisjen sa më shpejtë të jetë e mundur në mënyrë që të binden për të ndryshuar deklaratën dhe mos të përfshihet paragrafi i Çështjeve Tjera.

Firma e auditim mund të dojë të paraqitet dhe të flet para aksionarëve në takimin vjetor për të shpjeguar paragrafin shtesë në raportin e auditorit.

(b) (i) Data e nënshkrimit të raportit të auditorit

SNA 700 *formimi i një opinion dhe raportimi mbi pasqyrat financiare* kërkon që auditor të mos nënshkruaj dhe datoj raportin e auditorit para datës që anë konsideruar të gjitha dëshmitë e nevojshme të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Auditori nuk mund të arrijë në një opinion para se të gjitha dëshmitë janë vlerësuar, përfshirë letrën e përfaqësimit nga menaxhmenti. Edhe pse përmbajtja e letrës së përfaqësimit është diskutuar me menaxhmentin, partneri i auditimit nuk duhet të nënshkruaj raportin para se ajo letër të pranohet.

Përfaqësimet e shkruara janë pjesë e domosdoshme e dëshmive të auditimit. Në veçanti, përfaqësimet e shkruara bëhen lidhur me ngjarjet pas fundit të vitit. Nëse do të ndodhte ndonjë ngjarje domethënëse pasi që auditori ka lëshuar raportin, pasqyrat financiare do të duhej të ndryshoheshin prandaj edhe raporti i auditorit do të ishte i papërshtatshëm.

(ii) Opinioni i auditorit të vitit të mëparshëm

Rregulli i përgjithshëm është se auditori ka përgjegjësi të vetme të jap një opinion për pasqyrat financiare dhe nuk duhet ti refereohet palëve të tretë (siç janë ekspertët ose organizatat për ofrimin e shërbimeve) pasi që kjo mund të nënkuptoj se përgjegjësia i është deleguar palëve tjera. Mirëpo, SNA 710 *Informatat krahasuese – shifrat korresponduese dhe pasqyrat financiare krahasuese* thekson se është e pranueshme t'i referohemi auditorit të mëparshëm lidhur me shifrat korresponduese, për derisa nuk është e ndaluar me ndonjë ligj ose rregullorë. SNA 710 e bën të qartë se është zgjedhje e auditorit për t'iu referuar raportit të auditorit të mëparshëm.

Nëse bëhet një referencë e tillë, kjo do të përfshihej në paragrafin e Çështjeve Tjera, që vendoset direkt nën opinionin e auditorit. Paragrafi i Çështjeve Tjera duhet të përmbajë deklaratën se pasqyrat financiare të vitit të mëparshëm janë audituar nga një auditor tjetër, lloji i opinionit të dhënë dhe data e raportit.

Në këtë rast, pasi që opinionin e dhënë për pasqyrat financiare të vitit të mëparshëm është modifikuar, paragrafi i Çështjeve Tjera duhet të shpjegoj arsyen pse është modifikuar opinionin.

Detyra 5

(a) Ju jeni partneri përgjegjës për auditimin e Germia Shpk, për vitin që përfundon me 30 prill 2019. Auditimi final ka përfunduar dhe ju keni kërkuar nga menaxheri i auditimit të bëjë një draft raport të auditimit. Menaxheri është i vetëdijshëm se ka udhëzues për auditorët lidhur me raportet e auditimit, në SNA 706 Paragrafet e Theksimit të Çështjes dhe Paragrafët e Çështjeve Tjera në Raportin e Auditorëve të Pavarur. Menaxheri ka kërkuar ndihmën tuaj për këtë çështje.

Kërkohet:

- (i) Përkufizoni një 'Paragraf të theksimit të çështjes' dhe shpjegoni duke ofruar shembuj, përdorimin e një paragrafi të tillë; (6 pikë)
- (ii) Përkufizoni një 'Paragraf të çështjeve tjera' dhe shpjegoni duke ofruar shembuj, përdorimin e një paragrafi të tillë.

Shënim: Nuk kërkohet nga ju të shkruani një draft paragraf. (4 pikë)

(b) Disa nga juniorët e auditimit kanë kërkuar nga ju udhëzime sa i përket përgjegjësisë së auditorit. Atyre ju intereson të kuptojnë se si mund të zvogëlojë një firmë e auditimit ekspozimin ndaj pretendimeve për neglizhencë. Ata kanë dëgjuar se në disa vende është e mundur të kufizohet përgjegjësia duke bërë marrëveshje të kufizimit të përgjegjësisë me klientin e auditimit.

Kërkohet:

- (i) Shpjegoni KATËR metoda që mund të përdoren nga firma e auditimit për të zvogëluar ekspozimin ndaj pretendimeve gjyqësore; (4 pikë)
 - (ii) Vlerësoni implikimet e mundshme për profesionin, kur një firmë e auditimit nënshkruan marrëveshjen për kufizimin e përgjegjësisë me klientin e tyre. (6 pikë)
- (20 pikë)**

Zgjidhja

(a) (i) Paragrafi i theksimit të çështjes është paragraf i cili përfshihet në raportin e auditorit dhe që referohet një çështjeje që është shpalosur si duhet në PF, që sipas gjykimit të auditorit është me aq rëndësi sa është fundamentale për shfrytëzuesit të kuptojnë PF. SNA 706 Paragrafi i theksimit të çështjes dhe paragrafet e çështjeve tjera, tregojnë se paragrafi duhet të përdoret vetëm nëse auditori ka dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme që çështja nuk është anomaly materiale për PF. Një paragraf i tillë duhet t'referohet vetë informatave të prezantuara ose shpalosura në PF.

Paragrafi prandaj përdoret për të nënvizuar çështje fundamentale për shfrytëzuesit e PF. Nuk ka të bëjë me mosmarrëveshjen ose kufizimin e fushëveprimit dhe prandaj nuk është kualifikim i opinionit të auditorit. Paragrafi i theksimit të çështjes duhet qartë të theksojë se opinionin e auditorit nuk është modifikuar sa i përket çështjes së theksuar.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet të përfshijë referencë të qartë të çështjes e cila theksohet dhe referencë shpalosjes përkatëse në PF.

Shembuj janë ofruar në SNA 706 për situatat potenciale në të cilat përdoret paragrafi i theksimit të çështjes:

- Çfardo pasigurie lidhur me rezultatet e ardhshme të rasteve gjyqësore ose veprimeve rregullatore
- Aplikimi i hershëm i ndonjë standardi të kontabilitetit (në rast se lejohet) dhe që ka efekt të madh në PF.
- një katastrofë e madhe që ka pasur dhe vazhdon të ketë efekt domethënës në pozitën financiare të entitetit.
- Çështje domethënëse për vijimësinë e kompanisë (Shënim: tani kjo paraqitet në paragrafin e veçantë të pasigurisë për hipotezën e vijimësisë, studentët mund të marrin pikë të plota edhe nëse i referohen standardit të kaluar).

(ii) Paragrafi çështjeve tjera duhet të përfshihen në raportin e auditorit për t'iu referuar çështjeve tjera përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në PF, që sipas gjykimit të auditorit, është relevante për shfrytëzuesit e PF. 13

Shembuj të çështjeve të tilla përfshijnë:

- Ligji, rregulloret ose praktika e përgjithshme mund të kërkojë ose lejoj nga auditori të elaborojë çështjet që ofrojnë shpjegim të mëtutjeshëm për përgjegjësitë të auditorit në raport.
- Nga auditori mund të kërkojë të raportoj në më shumë se një set i PF (psh një set i PF sipas kornizës nacionale të raportimit dhe një set sipas SNRF).
- Çfardo kufizimi lidhur me shpërndarjen e raportit të auditimit.

Paragrafi prandaj përdoret si mjet që auditori mund të komunikojë një çështje shfrytëzuesve të PF. Përmbajtja e paragrafit duhet qartë të reflektojë se çështja nuk kërkojë të paraqitet ose shpaloset në PF.

Për të dyjat edhe paragrafet e theksimit të çështjes dhe paragrafet e çështjeve tjera duhet t'ikomunikohen me ata që janë përgjegjës për qeverisjen, të cilëve duhet tu komunikohet natyra e zërit specifik që auditori e ka nënvizuar.

(b) (i) Të gjitha firmat e auditimit duan të shmangin paditë gjyqësore për shkak të publicitetit të keq dhe kolapsit të mundshëm të firmës. Ka disa mënyra se si firmat e auditimit mund të zvogëlojnë ekspozimin ndaj pretendimeve.

Procedurat e pranimit të klientit

Firmat duhet të vlerësojnë në mënyrë të kujdesshme rrezikun e shoqëruar me klientët e mundshëm të auditimit. Duhet përdoren procedura për të identifikuar çështjet që kanë të bëjnë me ekspozimin e firmës së auditimit ndaj rrezikut. Çështja është se klienti duhet të pranohet nëse rreziku i shoqëruar mund të menaxhohet në një nivel të pranueshëm duke konsideruar nivelin e aftësive dhe burimeve të firmës së auditimit.

Pëdorimi i duhur i letrave të angazhimit

Letra e angazhimit duhet të përdoret për theksuar qartë përgjegjësitë e auditorit dhe menaxhmentit. Pasi që përfaqëson kontratë në mes të firmës së auditimit dhe klientit, duhet të azhurnohet në bazë vjetore, duke i kushtuar rëndësi që klienti është në dijeni për çardo ndryshim në fushëveprimin e auditimit, ose përgjegjësitë raportuese të firmës së auditimit.

Kryerja dhe dokumentimi i punës së auditimit

Firmat e auditimit duhet të sigurojnë se standardet profesional mirëmbahen si duhet dhe se Standardet Ndërkombëtare të Auditimit respektohen. Është me rëndësi të bëhet dokumentimi për të gjitha aspektet e auditimit, përfshirë planifikimin, vlerësimin e dëshmive dhe konsiderimin e çështjeve etike. Një pretendim për neglizhencë ka pak mundësi të jetë i suksesshëm nëse firma ka dëshmi të dokumentuara për janë ndjekur SNA-të.

Kontrolli i cilësisë

Firmat duhet të sigurojnë se janë implementuar procedurat e gjithmbarshme të firmës për kontrollin e cilësisë, si dhe procedurat e aplikueshme për angazhimet individuale të auditimit.

Kontrolli i cilësisë vepron si kontroll i brendshëm për një firmë të auditimit, që ndihmon të të digurohet se SNA dhe metodat e brendshme të auditimit janë ndjekur gjatë gjithë kohës.

Konsultimet e jashtme

Firmat duhet të përdorin specialist të jashtëm kur lind nevoja, për shembull marrja e këshillave ligjore për tu siguruar se veprimet e auditorëve janë të pranueshme Brenda kornizës ligjore dhe rregullatore.

Mohimi

Në vitet e fundit është bërë e zakonshme në disa jurisdiksione që firmat e auditimit të përfshijnë paragraf të mohimit në raportin e auditorit. Kjo është përpjekje për të kufizuar detyrën për të qenë i kujdesshëm ndaj aksionarëve të kompanisë, prandaj duke u përpjekur për të kufizuar detyrimin ligjor për atë klasë të aksionarëve. Mirëpo, mohimet mund të mos jenë gjithmonë efektive.

(ii) Një marrëveshje për kufizimin e përgjegjësisë është kufizim kontraktual e përgjegjësisë së auditorit ndaj kompanisë. Janë disa implikime për profesionin e auditimit që diskutohen më poshtë.

Cilësia e auditimit

Njëri ndër argumentet kryesore kundër përdorimit të këtyre marrëveshjeve është se mund të dëmtohet cilësia e auditimit. Argumenti është se auditorët mund të jenë më pak të shqetësuar me cilësinë e punës së tyre, pasi që nëse ekziston ndonjë pretendim për kompenzim ata ja të mbuluar sepse kanë një përgjegjësi të kufizuar.

Vlera e opinionit të auditimit

Si pasojë e pikëve më sipër, shumë argumentojnë se shfrytëzuesit e pasqyrave financiare do të kenë më pak besim të opinionin e auditorit, duke rezultuar kështu në pasqyra financiare më pak të besueshme.

Presioni për tarifat e auditimit

Konsiderohet se firmat mund të jenë nën presion nga klientët për të zvogëluar tarifat. Kjo është përgjigje ndaj faktit që nëse firma e auditimit ka zvogëluar rrezikun e ekspozimit, atëherë tarifa e auditimit mund të zvogëlohet.

Konkurrenca në tregun e auditimit

Aftësia për të vendosur një kufi në përgjegjësinë e auditorit, mund të çregullojë tregun e auditimit. Mirëpo, mund të argumentohet se aftësia për të vendosur kufi në përgjegjësinë e auditimit i ndihmon tregut të auditimit duke i mbrojtur ato nga kolapsi dhe mund të promovojë konkurrencën në mes të firmave të mëdha.